




AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE



**TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE
POSTARE**

2023

DREJTORIA E TREGJEVE DHE MASAVE RREGULLATORE

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesorë të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për vitin 2023, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP - www.akep.al, në seksionin “Statistika”.

Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare, duke përfshirë të dhënat më të fundit të disponueshme të tregut.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për vitin 2023 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “*Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare*”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “*Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare*”, si dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 1537/10 datë 03.03.2023 miratimin e dokumentit “*Mbi disa shtesa e ndryshime në rregulloren nr.40, datë 17.12.2015, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”*”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “*Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare*” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (35 subjekte):**
 1. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALOPOST sh.p.k.
 4. BIPEX sh.p.k.
 5. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
 6. DHL International (Albania) sh.p.k.
 7. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 8. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 9. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
 10. Greenposta shpk
 11. INTEX COURIER sh.p.k.
 12. IPOST sh.p.k.
 13. Milsped Albania sh.p.k.
 14. Mr. COURIER sh.p.k.
 15. POSTA JONË sh.p.k.
 16. POSTMAN sh.p.k
 17. T.N.T Express Albania sh.p.k.
 18. Top Post sh.p.k.
 19. Ultra C.E.P. sh.p.k.
 20. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)

21. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
22. Youth Albania Professional Services (YAPS)
23. Elite Post sh.p.k.

Në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.13, datë 30.06.2020, ka pajisur Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.

Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 38, datë 19/11/2015, “Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, subjektet e sipërcituar janë pajisur nga AKEP me Certifikatë të Konfirmimit të Njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit dhe evidenca e realizimit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimeve ekspres/jo universale;
4. Treguesit teknik dhe të rrjetit;
5. Cilësia / Standardet e realizimit të shërbimeve postare;
6. Të punësuarit;
7. Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet);
8. Të ardhurat financiare nga shërbimet postare.

Posta Shqiptare, si ofrues i shërbimit universal postar ka plotësuar Formularin A me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga pika A deri në pikën H, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë plotësuar Formularin C me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga A deri në pikën G.

IV. TRAJTIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

Të dhënat e dërguara dhe të trajtuara në këtë raport jepen për zërat kryesorë të shërbimeve postare, në të cilat përfshihen nën-zërat e tyre.

Paraqitja e të dhënave është bërë në mënyrë tabelore dhe grafike duke ju referuar të dhënave për objektet postare të pranuar, si dhe krahasimi me vitet paraardhëse.

1. Të dhëna përmbledhëse të shërbimeve postare

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2023 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 23.11 milionë, një rënie me 15% krahasuar me vitin 2022.

Kjo rënie ka ardhur kryesisht nga rënia e totalit të shërbimeve postare të Postës Shqiptare me afërsisht 16% krahasuar me një vit më parë. Rënie ka shënuar zëri ‘Postë brenda vendit’ në Sh. U me 17% krahasuar me vitin 2022, ndërsa zëri ‘Postë ndërkombëtare’ ka pësuar rritje me 2%. Gjithashtu, rënie ka pësuar dhe Shërbimi Ekspres për P.Sh krahasuar me vitin 2022, përkatësisht me 9% për zërin ‘Ekspres brenda vendit’ dhe 18% për zërin ‘Ekspres Ndërkombëtar’.

Në lidhje me Shërbimin jo Universal për P.Sh, zëri ‘Postë brenda vendit’ ka pësuar rënie me 1%, ndërsa zëri ‘Postë ndërkombëtare’ është rritur me 5% krahasuar me një vit më parë.

Për sa i përket Ofruesve të tjerë të Shërbimeve Postare, Shërbimi jo Universal ka pasur një rënie të konsiderueshme në masën 52% krahasuar me vitin 2022, qoftë për zërin ‘Postë Brenda vendit’ ashtu edhe për zërin ‘Postë Ndërkombëtare’. Ndërsa shërbimi Ekspres ka pësuar rritje me 6% në totalin e tij krahasuar me vitin e kaluar, ku zëri ‘Ekspres Ndërkombëtar’ ka pasur një rritje të konsiderueshme në masën 66%.

Tabela 1.1: Të dhëna mbi kategoritë kryesore të objekteve postare (2022-2023)

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2022	Objekte postare 2023	Ndryshim 2023/2022
Posta Shqiptare sh.a				
1	Shërbim Universal Postar			
1.1	Postë brenda vendit	21,229,943	17,652,148	-17%
1.2	Postë ndërkombëtare	729,430	743,008	2%
1.3	Totali 1.1+1.2	21,959,373	18,395,156	-16%
2	Shërbim joniversal postar			
2.1	Postë brenda vendit	406,700	402,014	-1%
2.2	Postë ndërkombëtare	3,149	3,320	5%
2.3	Totali 2.1+2.2	409,849	405,334	-1%
3	Shërbim ekspres			
3.1	Ekspres brenda vendit	541,210	491,782	-9%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	15,177	12,400	-18%
3.3	Totali 3.1+3.2	556,387	504,182	-9%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4.1	Postë brenda vendit	956,465	457,644	-52%
4.2	Postë ndërkombëtare	45,072	21,847	-52%
4.3	Totali 4.1+4.2	1,001,537	479,491	-52%
5	Shërbim ekspres			
5.1	Ekspres brenda vendit	2,867,337	2,883,871	1%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	267,416	442,779	66%
5.3	Totali 5.1+5.2	3,134,753	3,326,650	6%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	27,061,899	23,110,813	-15%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për vitin 2023, rezultojnë 23,110,813 objekte postare gjithsej, në raport me popullsinë (banorë rezident¹) janë rreth 8 objekte / banorë.

2. Treguesit dhe evidenca e realizimit të Shërbimit Universal Postar


Posta Shqiptare bazuar në Autorizim Individual të lëshuar nga AKEP gëzon të drejtën si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar deri në vitin 2025.

Volumin kryesor në shërbimin universal postar brenda vendit e zënë ‘Objektet e thjeshta’ me 14,455,766 objekte ose 82% të ndjekura nga ‘Objektet e regjistruara’ me 3,196,382 objekte ose rreth 18% të këtij treguesi.

¹ Popullsia 1 Janar 2023, INSTAT


Në grafikët 2.1 dhe 2.2 të paraqitur më poshtë, jepen të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimit universal postar brenda vendit të pranuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal gjatë vitit 2023, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve në raport me vitet paraardhëse.

Grafiku 2.1: Treguesit e Shërbimit Universal brenda vendit për vitin 2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP


Grafiku 2.2: SH.U brenda vendit- Ecuria në vite (numër objektiv)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.2 vihet re se në vitin 2023 ka një rënie prej 17% të numrit të objekteve postare brenda vendit krahasuar me 2022.


Grafiku 2.3: SH.U. - Postë ndërkombëtare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.3 vihet re se volumin kryesor në shërbimin universal postar ndërkombëtar për Objektet Postare të pranuara në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë ‘Objektet e regjistruara’ me 127,357 objekte ose 84% të ndjekura nga ‘Objektet e thjeshta’ me 23,567 objekte ose 16%. Për objektet hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë ‘Objektet e regjistruara të veçanta’ me 368,088 objekte ose 62% të ndjekura nga ‘Objektet e thjeshta’ me 223,996 objekte ose 38%.

Grafiku 2.4: Treguesi i SH.U për Postë ndërkombëtare 2018 – 2023




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.4 vihet re se gjate vitit 2023 Posta Shqiptare ka realizuar gjithsej 743,008 objekte postare të pranuara në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri. Gjithashtu evidentohet se Posta ndërkombëtare e përpunuar nga ofruesi i Shërbimit Universal ka pasur një rritje prej 2% në 2023 krahasuar me 2022.

3. Treguesit e shërbimit jo-universal postar

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal përgjatë vitit 2023 për Postën Shqiptare rezulton 402,014 objekte. Në grafikun në vijim paraqiten të dhënat mbi shërbimin jo-universal:


Grafiku 3.1: Shërbimi jo-universal brenda vendit nga Operatorët e tjerë postarë (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Operatorët e tjerë postarë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.1 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar brenda vendit për Operatorët e tjerë postar e zënë ‘Jo dokumente Pako/Koli’ me 296,009 objekte ose 65% të ndjekura nga ‘Objekte të thjeshta’ me 161,112 objekte ose 35%, ‘Të tjera’ me 523 objekte ose 0.1%.


Grafiku 3.2: Shërbimi jo-universal postar brenda vendit P.SH / Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga grafiku 3.2 vihet re se Posta shqiptare mbulon 47% të shërbimit jo universal postar brenda vendit me 402,014 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë 53% të ketij shërbimi me 457,644 objekte. Vlen për tu theksuar se në krahasim me vitin e kalur ky raport ka ndryshuar pasi në 2022 Posta Shqiptare mbulonte 30% të shërbimit jo-universal postar brenda vendit me 406,700 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulonin 70% me 956,465 objekte. Por gjithashtu dhe volumi total ka pësuar rënie me 37 % për të dy ofruesit e shërbimit.


Grafiku 3.3: Shërbimi jo-universal postar ndërkombëtar – Posta Shqiptare (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.3 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Postën Shqiptare për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë ‘Objektet e regjistruara’ me 1,437 objekte ose 100%, ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri volumin kryesor e zënë ‘Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta’ me 1,883 objekte ose 100%.

Grafiku 3.4: Shërbimi jo-universal postar ndërkombëtar – Operatorët e tjerë (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.4 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Operatorët e tjerë postar për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë ‘Jo dokumente Pako/Koli’ me 698 objekte ose 74%, të ndjekura nga ‘Objektet e korrespondencës’ me 250 objekte ose 26%.

Edhe për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë ‘Jo Dokumente Pako/Koli’ me 11,939 objekte ose 57%, të ndjekura nga ‘Objektet e korrespondencës’ me 8,960 objekte ose 43%.


Nga të dhënat e raportuara vihet re se Posta shqiptare mbulon 7% të shërbimit jo-universal postar ndërkombëtar me 3,149 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 93% me 45,072 objekte.

Gjithashtu, vihet re se Posta shqiptare mbulon 46% të shërbimit jo-universal postar (kombëtar dhe ndërkombëtar) me 405,334 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 54% me 479,491 objekte.

4. Treguesit e shërbimit Ekspres

Zëri ‘Shërbimi ekspres’ është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, në një kohë të shkurtër, shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave.

Grafiku 4.1: Shërbimi ekspres – Posta Shqiptare




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.1 vihet re se 97% e shërbimit ekspres brenda vendit përfaqësohet nga 'Dokumente', ndërsa në shërbimin ekspres ndërkombëtar 80% e shërbimit përfaqësohet nga 'Objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit' dhe 20% nga 'Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri'.

Nga të dhënat e grafikut 4.1 vihet re se për Postën Shqiptare 98% e shërbimit ekspres mbulohet nga shërbimi ekspres brenda vendit dhe vetëm 2% nga shërbimi ekspres ndërkombëtar.

Grafiku 4.2: Shërbimi ekspres në total – Posta Shqiptare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.2 vihet re se për Postën Shqiptare gjatë vitit 2023 shërbimi ekspres në total (brenda vendit dhe ndërkombëtar) ka pësuar rënie me rreth 10% në krahasim me vitin e kaluar.

Në vijim jepen në formë tabelore dhe grafike të dhënat statistikore për Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimet ekspres, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e tyre.


Tabela 4.2: Shërbimi ekspres për Ofruesit e Tjerë (viti 2023)

	Totali	Albanian Delivery Express sh.p.k.	BIPEX sh.p.k.	DHL International (Albania) sh.p.k.	Mr. COURIER sh.p.k.	T.N.T Express Albania sh.p.k.	Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)	United Transport sh.p.k. (Uni Trans)	Operatorët e tjere
Shërbimi ekspres									
Ekspres brenda vendit	2,883,871	1,542,651	171,597	39,217	16,490	159,057	-	549,057	405,802
Ekspres ndërkombëtar	442,779	42,996	171,211	152,588	-	4,411	40,388	31,146	39

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Referuar tabelës 4.2 rezulton se për ofruesit e shërbimeve postare ekspres brenda vendit treguesit më të lartë për objektet e pranuar i ka Albanian Delivery Express me 1,542,651 objekte, ndërsa për objektet ekspres ndërkombëtare treguesit më të lartë i ka BIPEX me 171,211 objekte. Për sa i përket mbulimit të tregut postar në lidhje me shërbimin ekspres për ofruesit e tjerë, shërbimi ekspres brenda vendit përbën 87%, ndërsa shërbimi ekspres ndërkombëtar përbën 13%, siç evidentohet dhe në grafikun më poshtë.


Grafiku 4.3: Numri total i objekteve postare për Ofruesit e Tjerë (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP


Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër rezulton se gjatë vitit 2023 ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar 3,326,650 objekte postare që i përkasin shërbimit ekspres ose 87% dhe 479,491 objekte postare që i përkasin shërbimit jo-universal ose 13%. Për vitin 2023 Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 87% të tregut ekspres dhe Posta Shqiptare mbulon 13% të tregut ekspres.

Grafiku 4.4: Totali i objekteve postare – P.SH / Ofruesit e tjerë



Për sa i përket të dhënave të paraqitura në grafikun më sipër për vitin 2023 Posta Shqiptare ka realizuar 19,304,672 objekte postare në total ose 84% kundrejt 3,806,141 objekte postare në total për gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në total ose 16%.

Grafiku 4.5: Numri total i objekteve postare – P.SH + Ofruesit e tjerë – Ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.5 vihet re se gjatë vitit 2023 ka pasur një rënie prej 330,149 objekte postare ose rënie me 8% krahasuar me vitin 2022.

5. Treguesit teknik të rrjetit postar


Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në 535 zyra të hapura për publikun, që e bën atë operatorin me shpërndarjen më të madhe në vend, e ndjekur nga United Transport, Air Cargo Service, Albanian Delivery Express, Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex), TNT etj.

Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal 704 sportele, nga të cilët 525 sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Për pranimin e objekteve postare ka vënë ne dispozicion të përdoruesve 579 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 667 kuti postare, gjithsej 1,246 kuti postare.


Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Grafiku 5.1/1: Treguesit teknik për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë Zyra/Sportele/Kuti Postare (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP


Grafiku 5.1/2: Treguesit teknik për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë / Automjete (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Siç vihet re edhe nga Grafiku 5.1/2 për sa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 153 mjete transporti, Ulysses Enterprises (Fedex) 118, United Transport 103, Albanian Delivery Express 94, të pasuar nga Ofruesit e tjerë. Në mjetet e transportit përfshihen kamionë, furgonë, vetura, motorë, motoçikleta dhe biçikleta.

Grafiku 5.2: Treguesit teknik të rrjetit – Posta Shqiptare/Ofruesit e tjerë (viti 2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

6. Cilësia dhe standardet e shërbimit postar

Sipas nenit 33 të Ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” AKEP-i, me rregullore (Rregullorja Nr.36 Datë 29.10.2015), përcakton standardet për cilësinë e shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit me cilësi të mirë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Tabela 6.1: Cilësia dhe standardet e Shërbimit Universal Postar brenda vendit 2017 – 2023

	Standardi	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Brenda qytetit								
D+1	95%	96	96	97	95	97	97	97%
D+2	5%	4	4	4	4	4	4	3%
Midis qyteteve								
D+1	85%	95	95	95	94	96	96	97%
D+2	15%	6	5	5	6	4	4	4%
Në fshatra								
D+2	60%	77	78	81	80	84	85%	85%
D+3	20%	20	20	19	20	16	15%	11%
D+4	20%	3	2	0	0	0	0	4%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP


Sipas të dhënave të raportuara nga Posta Shqiptare të paraqitura në tabelën 6.1 rezulton se Posta Shqiptare ka realizuar treguesit për kohën e shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit në të tre destinacionet dhe për të gjitha kohëzgjatjet. Në vitin 2023 treguesit kanë qënë pothuajse në të njëjtat nivele me 2022. Posta Shqiptare realizon në D+1 dorëzimin e 97% të objekteve postare brenda qytetit dhe 97% të objekte midis qyteteve. Në vitin 2023 niveli i shpërndarjes së objekteve postare në fshatra në D+2 ka qënë 85%, në të njëjtin nivel me vitin 2022.

7. Të punësuarit

Në funksion të volumit të punës Posta Shqiptare ka 2,520 të punësuar, ndërsa operatorët e tjerë kanë në total 642 të punësuar, me respektivisht TNT, United Transport, Ultra C.E.P dhe DHL ndër operatorët e tjerë me numrin më të madh të të punësuarve.

Nga të dhënat e raportuara, Posta Shqiptare mbulon 80% të tregut postar të të punësuarve në total me 2,520 persona kundrejt 20% të ofruesve të tjerë së bashku ose 642 persona.

Grafiku 7.1: Numri i të punësuarve ndër vite




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 7.1 vihet re se një rënie e lehtë e numrit të të punësuarve në sektorin postar, konkretisht në vitin 2023 ka pasur një rënie me 1%.

8. Ankesat

Sipas të dhënave të dërguara, gjatë vitit 2023 pranë operatorit Posta Shqiptare janë depozituar 850 reklamacione, pranë Intex Courier janë depozituar 367 reklamacione, pranë Albanian Delivery Express janë depozituar 87 reklamacione, pranë DHL janë depozituar 47 reklamacione dhe pranë United Transport sh.p.k. (Uni Trans) 39 reklamacione. Nga reklamacionet e mësipërme Intex Courier ka zgjidhur 298 reklamacione nga 367 të depozituara, ndërsa subjektet e tjera i kanë zgjidhur plotësisht.

Grafiku 8.1: Numri i ankesave pranuar dhe të zgjidhura



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të pranuar, gjatë vitit 2023 vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të ankesave për ofruesin e shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2022, gjithashtu nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të zgjidhura gjatë vitit 2023 vërehet se 100% e ankesave janë zgjidhur nga ofruesi i shërbimit universal dhe 87% e ankesave janë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, në ndryshim nga viti 2022 me 100% të ankesave të zgjidhura.

9. Rezultatet financiare

Në zbatim të ligjit Nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” AKEP mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore.


Të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve postare përgjatë vitit 2023 janë raportuar² rreth 2.5 miliardë lekë, çka përbën një ulje me rreth 5% në raport me vitin 2022.

Përgjatë vitit 2023 është vërejtur se disa nga operatorët kryesorë në treg kanë shënuar rënie të ardhurash krahasuar me vitin 2021, konkretisht rënien më të ndjeshme e kanë pasur DHL (10%), TNT (52%) dhe United Transport me rreth (46%).

Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2023. Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2023 kanë rënë me rreth 5% në krahasim me vitin 2022.

Grafik 9.1: Pjesë tregu në të ardhurat e sektorit postar

² Të ardhurat dhe investimet e raportuara deri më datë 30 Prill




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 9.1 vihet re se Posta Shqiptare mbulon pjesën më të madhe të të ardhurave me rreth 53%, e ndjekur nga DHL me 19%, Albanian Delivery Express me 8%, United Transport me 4%. Operatorët e tjerë të gjithë së bashku mbulojnë rreth 13% të totalit të të ardhurave nga sektori postar.

Për sa i përket të ardhurave të Postës Shqiptare, rreth 86% e të ardhurave janë gjeneruar nga shërbimi universal postar, ndjekur nga shërbimi postar ekspres me 13 %, dhe shërbimi jo universal me 1%.

Grafik 9.2: Ecuria e të ardhurave dhe investimeve 2018-2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Investimet e realizuara nga ofruesit e shërbimeve postare përgjatë vitit 2023 raportohen rreth 282.5 milionë lekë, ose rreth 31% më pak se viti pararendës, nga të cilat peshën më të madhe ose rreth 85% të totalit e zënë ofruesit e tjerë të shërbimit postar dhe 15% Posta Shqiptare.